



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (KHE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Regjistrimi i shpenzimeve në vlerë të përgjithshme 68,900€ ishte bërë në kategoritë ekonomike jo përkatëse.
- A2 Ne Pasqyrat Financiare Vjetore (Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit), në pjesën e hyrjeve të parasë, donacionet e realizuara janë mbivlerësuar për 22,772€. Gjithashtu, te shënimet shpjeguese për shpалosjen e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, buxheti fillestar për paga e rroga është mbivlerësuar për 28,219€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit.
- A4 Mangësi në vlerësimin e tenderit.
- A5 Parregullsi në procesin e subvencionimit. Komuna nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ). Gjithashtu, nuk është përgatitur Raporti vjetor për projektet e financuara si dhe dobësi në vlerësimin e aplikacioneve dhe monitorimit të subvencioneve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit, mangësi në vlerësimin e tenderit, parregullsitë në procesin e subvencionimit, vonesa në pagesën e obligimeve, mangësitë në menaxhimin e pasurisë jofinanciare dhe dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PVF-të të cilat përmbanin gabime në prezantim. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike jo përkatëse

Gjetja

Sipas nenit 18, paragrafi 3 i rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të jenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Me planin kontabël të thesarit janë përcaktuar kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike me të cilat regjistrohen dhe klasifikohen shpenzimet.

Nga buxheti i investimeve kapitale janë paguar 31,069€ për furnizim me paisje dhe mobile që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore, nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve janë paguar 37,831€ për shpenzime që për nga natyra i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit jo të drejtë të buxhetit, duke përfshirë në buxhetin e investimeve kapitale planifikime që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe pagesave të realizuara nga Thesari si rezultat i vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë, ndikon në pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në shënimet shpjeguese të pasqyrave vjetore financiare

Gjetja Rregullorja MF-Nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga OB, ka përcaktuar kërkesat për prezantimin e informatave financiare për kategoritë buxhetore, përfshirë edhe shënimet shpjeguese për secilën kategori.

Ne Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, në pjesën e hyrjeve të parasë, donacionet e pranuar gjatë vitit 2021 janë mbivlerësuar për 22,772€. Në vend të pranimeve, Komuna kishte prezantuar vlerën e pagesave të realizuara gjatë vitit nga fondi i donacioneve.

Gjithashtu, te shënimet shpjeguese për shpалosjen e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, buxheti fillestar për paga e rroga është mbivlerësuar për 28,219€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme dhe joefektive në përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare.

Ndikimi Shënimet shpjeguese të pasakta pamundësojnë prezantimin e drejtë të informatave financiare për Qeverinë, qytetarët dhe palët tjera të interesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që të dhënat financiare për buxhetin dhe shënimet shpjeguese të prezantohen të plota dhe të sakta në pasqyrat financiare të vitit 2022, sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit

Gjetja Ligji Nr. 06/L-114 për zyrtarët publik (LZP), neni 68, përcakton që hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga njësia e burimeve njerëzore, në ueb faqen e konkurrimeve të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj). Gjithashtu me nenin, 68, pika 7, përcakton që komisioni i përzgjedhjes është ad hoc, themelohet nga organi emërtues dhe përbëhet nga të paktën 5 persona.

Neni 6, pika 3.1, e UA (MASH) nr. 151/2020 për procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës për drejtor dhe zëvendës drejtor, përcakton që dy anëtar të komunës, propozohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) dhe miratohen nga Kuvendi Komunal (KK). Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë duhet të jetë njëri nga këta: ekspert i pavarur i arsimit, drejtor me performancë të lartë, përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e edukimit.

Në procedurat e rekrutimit për pozitat Drejtor i Shkollës dhe Mjek i Mjekësisë Familjare, përveç konkursit, asnjë informatë tjetër e procesit të rekrutimit nuk ishte publikuar në ueb faqen e komunës. Komisionet e pranimit për punonjësit e shërbimit publik ishin me nga tre (3) anëtar, ndonëse me LZP kërkohet që komisioni të përbëhet nga të paktën me (5) pesë anëtar.

Në komisionin e pranimit për pozitën Drejtor Shkolle, një anëtare e komisionit ishte me profesion farmacistë. Gjithashtu, në komisionin e pranimit ishte angazhuar vetëm një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit. I punësuar nuk kishte ofruar deklaratën (Formularin I) nën betim që nuk ka dhe nuk ka pasur funksione udhëheqëse në ndonjë parti politike, si dhe kishte sjellë vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime më të vjetër se gjashtë muaj. Këto dokumente ishin kërkuar me konkurs.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për procedurat e rekrutimit të personelit.

Ndikimi Mos publikimi i njoftimeve rreth procedurave të rekrutimit krijon jo transparencë dhe u pamundëson kandidatëve informimin rreth procesit të rekrutimit. Mos zbatimi i procedurave dhe kërkesave ligjore të rekrutimit pamundëson përzgjedhjen e kandidatëve meritor dhe kompetent për pozitat e punës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas LZP-së, dhe se njoftimet dhe procedurat e rekrutimit të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurrimeve të SIMBNj-së dhe ueb faqes së komunës. Komisioni i pranimit të përzgjedh vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në vlerësimin e tenderëve

Gjetja Në njoftimin për kontratë, përveç kërkesave tjera, ishte kërkuar që operatorët ekonomik (OE) të sjellin katalogun e produkteve të vulosur dhe të nënshkruar.

Te procedura e prokurimit publik për Furnizim me material administrativ, në vlerë të parashikuar 9,980€, fituesi i tenderit nuk kishte sjellë katalog me informata dhe specifika përkatëse të produkteve të ofruara, por një dokument të pa nënshkruar dhe të pavulosur të produkteve të fotografuara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga zyra e prokurimit gjatë vlerësimit të tenderëve.

Ndikimi Në mungesë të informatave dhe specifikave sipas kërkesave përkatëse, produktet e kontraktuara mund të mos jenë në formatin dhe cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që komisioni i vlerësimit të tenderëve rekomandon për kontratë vetëm ofertuesit më të suksesshëm që plotësojnë kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Parregullsi në procedurat e subvencionimit të projekteve**

Gjetja Rregullorja MF. Nr. 04/2017, neni 12, përcakton që thirrja publike duhet të jetë e hapur për së paku 15 ditë pune, ndërsa neni 8, përcakton që komisioni vlerësues përbëhet nga pesë anëtarë. Me nenin 7, kërkohet që për çdo marrëveshje për subvencionim të caktohet zyrtari monitorues. Kjo rregullore obligon OB-të të përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe ta dërgojnë atë në zyrën përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit (ZKM). Gjithashtu, me nenin 26, kërkohet që raporti vjetor për subvencionet e dhëna, t'i dërgohet ZKM-së më së largu deri më 1 mars.

Komuna nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ). Gjithashtu, nuk është përgatitur Raporti vjetor për projektet e financuara, dhe as nuk ishte publikuar në web faqen e komunës lista e përfituesve. Te subvencionimi i projektit për klubin futbollistik me vlerë 10,000€ dhe projekti për mbështetje të klubit të mundjes me vlerë 3,000€, kohëzgjatja e shpalljes publike ishte vetëm 11 ditë pune, derisa komisioni i vlerësimit ishte i përbërë me vetëm 3 anëtarë.

Komuna nuk kishte caktuar zyrtar përgjegjës për monitorimin e subvencioneve të dhëna. Përfituesi i subvencionit për mbështetje të klubit të futbollit, në aplikacionin e tij kishte bashkëngjitur projektpropozimin e vitit 2020, ndërsa raporti financiar i ofruar nga përfituesi përmbante dëshmitë e faturave të vitit 2020 e jo ato të vitit 2021. Gjithashtu, edhe përfituesi i projektit për mbështetje të klubit të mundjes, në raporti financiar të dorëzuar në komunë kishte bashkëngjitur faturat e vitit 2020 dhe disa të vitit 2021, por që i takojnë periudhës para aplikimit për subvencion. Te projekti

furnizimi me biomasë për nxehje qendrore për dy shkolla fillore në vlerë 1,000€, përfituesi i mbështetjes financiare nuk kishte dorëzuar raport financiar dhe narrativ.

Kjo ka ndodhur shkak i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për subvencionim.

Ndikimi

Mungesa e planeve vjetore pamundëson informimin paraprak të palëve të interesit dhe OJQ-ve. Mos respektimi i rregullave për mbështetjes financiare rritë mundësin e parregullsive gjatë procesit të subvencionimit. Projektet mund të mos zbatohen në mungesë të monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që afatet kohore për thirrjen publike dhe përbërja e komisionit vlerësues të jenë sipas kërkesave ligjore. Të caktohen zyrtarët përgjegjës për monitorim, dhe të kërkohet nga përfituesit të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative. Plani vjetor i mbështetjes financiare dhe Raporti vjetor të përgatiten dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të ZKM-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve si dhe investimet kapitale.

Çështja A6 - Nënshkrimi i kontratës publike pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK, si dhe lëshimi i urdhërblërjeve pas skadimit të kontratave

Gjetja

Neni 36.1 i Ligjit 05/L-063 për LMFP, përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK). Sipas Rregullës financiare, neni 17, urdhërblërja krijohet dhe përgatitet nga ana e OB-së, pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata.

Për kontratën publike Furnizim me material administrativ në vlerë 8,400€, zotimet e pjesërishme të mjeteve në SIMFK janë bërë pas një muaji nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në pesë raste⁴, zyra e prokurimit kishte përgatitur urdhërblërjet pas skadimit të kontratave publike. Vlera e përgjithshme e tyre ishte 37,267€, dhe se të njëjtat janë lëshuar prej dy javë deri një muaj pas skadimit të kontratës publike.

Gjithashtu, dy zotime të mjeteve dhe katër urdhërblërje në vlerë 36,370€ ishin përgatitur pas pranimit të faturave apo pas pranimit të furnizimeve/punimeve. Rastet kanë të bëjnë me:

- Zotimi dhe urdhërblërja në vlerë 1,560€ për furnizim me material për laborator, janë përgatitur 52 ditë pas pranimit të faturës apo 81 ditë pas pranimit të furnizimeve.
- Zotimi dhe urdhërblërja në vlerë 4,392€ për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale, janë bërë 77 ditë pas pranimit të faturës dhe shërbimeve.
- Urdhërblërja për kontratën publike Shtrim me kubëza në zonën urbane dhe rurale lot 1 në vlerë 24,883 urdhërblërja ishte përgatitur 2 ditë pas pranimit të punimeve.
- Urdhërblërja për furnizim me dru për nevoja të shkollës, në vlerë 5.535€ ishte përgatitur 4 ditë pas pranimit të furnizimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme dhe jo efektive në proceset e prokurimit publik.

Ndikimi

Përgatitja e zotimit dhe urdhërblërjeve me vonesë mund të ndikojë që kontratat të mos realizohen në mungesë të mjeteve të nevojshme buxhetore, si dhe paqartësi në realizim dhe liferim të mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që nënshkrimi të kontratës ti paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të pasohet më tej me përgatitjen e urdhërblërjes për furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së në fund të vitit 2021 është 16,584,796€, ndërsa e pasurive jokapitale e prezantuar në PVF e vitit 2021 është 50,973€, si dhe e stoqeve 24,420€.

Çështja B1 - Parregullsi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare

Gjetja

Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare, neni 6, pika 2, përcakton që regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale, pasuritë jokapitale, dhe stoqet. Gjithashtu kërkohet që në fund të vitit të bëhet inventarizimi fizik i pasurisë.

Komuna nuk ka përdorur programin e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe stoqeve. Regjistrimet për pasurinë jofinanciare janë mbajtur në formatin excel. Në PVF është prezantuar vetëm pasuria e blerë në vitin 2021, por jo edhe pasuritë e blera në vitet e mëparshme. Regjistri i pasurisë jokapitale nuk mund të konsiderohet i saktë, pasi prezantonte vetëm vlerën 50,973€, përderisa në vitin paraprak komuna kishte prezantuar pasuri në vlerë 188,737€. Gjithashtu, regjistri i stoqeve i prezantuar në vlerë 24,420€ nuk është i plotë, për shkak se nuk ishte bërë regjistrimi i stoqeve në fund të vitit 2021. Gjatë ekzaminimit kemi identifikuar se shtatë (7) laptop në vlerë totale 5,334€ nuk ishin përfshirë në regjistrin e stoqeve.

Komuna nuk ka bërë inventarizimin vjetor të pasurisë jofinanciare para përfundimit të vitit, por në pjesën e parë të vitit 2022.

Kjo ka ndodhë për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme për funksionalizimin e programit e-pasuria, si dhe mos inventarizimit me kohë të pasurisë.

Ndikimi

Mangësitë aktuale përveç ndikimit negativ që kanë në raportimin financiar, pamundëson gjithashtu menaxhimin efikas të pasurisë. Mbajtja e evidencave manuale të të dhënave paraqet rrezik për lëshimin e gabimeve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se programi e-pasuria fillon së aplikuari, dhe se të gjitha pasuritë regjistrohen dhe klasifikohen si duhet në regjistrin e pasurisë. Gjithashtu, të sigurohet përmbushja e kërkesës ligjore për inventarizimin e pasurisë para përgatitjes së pasqyrave financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Hanit të Elezit në PFV e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LI/A) në vlerë 643,147€, ku në raport me vitin 2020 të arkëtueshmet janë rritur për 20%. Kryesisht kjo rritje përbëhet nga të hyrat e pa arkëtuara nga tatimi në pronë.

Çështja A7 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€). dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk ka arritë të menaxhojë si duhet llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme kanë trend rritës përgjatë tre viteve, ku në fund të vitit 2021 të arkëtueshmet kishin arritur vlerën prej 643,147€, duke shënuar rritje për 20% apo 108,795€ në raport me të arkëtueshmet e vitit 2020 që ishin 534,352€. Pjesa më e madhe e LI/A ka të bëjë me tatimin në pronë të cilat kanë arritur vlerën 377,241€ apo 59% e saldove totale të LI/A. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete ligjore për të detyruar tatimpaguesit që të kryejnë obligimet ndaj Komunes.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate në menaxhim dhe inkasim të të hyrave që rrjedhimisht ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mos inkasimi i LI/A reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Njëkohësisht kjo mund të ndikojë në programin vjetor të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Detyrimet e papaguara

Sipas PVF, obligimet financiare të papaguara në fund të vitit 2021 ishin 61,529€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar me buxhetin e vitit 2022.

Çështja A8 - Vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve

Gjetja

Neni 37.2 dhe neni 39 i LMFPP, përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimit të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Obligimet e papaguara për vitin 2021 në total arrijnë shumën prej 61,529€ që krahasuar me vitin paraprak ka rritje prej 23,990€. Pesë (5) fatura në vlerë totale 34,036€ nuk ishin regjistruar në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës nga data e pranimit, derisa tri nga to janë protokolluar në vitin 2022. Këto obligime ishin shpalosur në PVF të vitit 2021 si obligime të papaguara. Gjithashtu, tre pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë totale 11,476€ ishin paguar pas afatit ligjor 30 ditor, dhe se vonesat ishin nga 24 ditë deri 4 muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pa mjaftueshme në menaxhimin e borxheve dhe sipas shpalosjeve në PVF obligimet nuk janë paguar në mungesë të buxhetit.

Ndikimi

Pagesa me vonesë e obligimeve ndaj furnitorëve mund ta ekspozojë Komunën para padive për mos pagesë me kohë të obligimeve dhe kjo do të shkaktojë kosto shtesë buxhetore për shkak të kamatave dhe shpenzimeve të përmbarimit.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen brenda afatit dhe obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,520,166	2,679,094	2,634,282	3,087,212	3,133,209
Grante Qeveritare - Buxheti	2,231,542	2,260,149	2,253,482	2,710,574	2,582,109
Financimi përmes huamarrjes	0	6,157	6,157	17,955	5,882
Të bartura nga viti i kaluar	0	57,780	57,002	84,716	169,163
Të hyrat vetanake	288,624	288,624	253,181	187,496	259,569
Donacionet vendore	0	30	0	0	54,970
Donacionet e jashtme	0	66,354	64,459	86,471	61,516

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 158,928€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 57,780€, financimet nga huamarrja në vlerë 6,157€, donacioneve në vlerë 66,384€, dhe vendimeve të qeverisë për 28.607€.

Në vitin 2021 Komuna e Hanit të Elezit ka shpenzuar 98% të buxhetit final, me një përmirësim prej 4% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,520,166	2,679,094	2,634,282	3,087,212	3,133,209
Pagat dhe mëditjet	1,602,781	1,645,045	1,644,863	1,577,267	1,478,773
Mallrat dhe shërbimet	335,258	355,065	348,741	382,355	261,826
Komunalitë	67,000	65,100	64,900	61,959	54,369
Subvencionet dhe transferet	75,000	80,290	72,465	155,946	66,103
Investimet Kapitale	385,127	533,593	503,312	909,685	1,272,138
Rezervat	55,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga e mëditje është rritur për 42,264€. Buxheti i kësaj kategorie është rritur për 6,157€ nga fondi financimet për huamarrje, 7,500€ nga donacionet e jashtme, dhe 28,607€ me vendimet e Qeverisë. Buxheti shtesë është dedikuar për shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, social dhe drejtorinë e inspeksionit.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 19,807€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat e bartura në vlerë 7,079€, nga donacionet 10,828€, si dhe 1,900€ janë transferuar nga buxheti i shpenzimeve komunale.
- Buxheti për shërbimet komunale është zvogëluar për 1,900€, dhe kjo shumë është alokuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 5,290€, dhe kjo rritje e buxhetit rrjedhë nga të hyrat e bartura të vitit paraprak.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 148,466€. Kjo rritje e buxhetit rrjedhë nga të hyrat e bartura nga viti paraprak në vlerë 45,410€, nga donacionet e jashtme në vlerë 48,056€, dhe 55,000€ të transferuara nga fondi i rezervave. Programi i Investimeve Publike të përfshira në ligjin e buxhetit përfshinë pesë (5) projekte të reja të vitit 2021 dhe 16 projekte në vazhdim nga viti i kaluar.

Komuna e Hanit të Elezit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 51,295€, të cilat janë shfrytëzuar për financimin e pagave dhe mëditjeve për shërbimet e shëndetësisë primare, shërbimet sociale, dhe në sektorin e arsimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e planifikuara për vitin 2021 ishin 288,624€, ndërsa janë realizuara 316,657€, duke tejkaluar planin për 28,033€ apo rreth 10%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, licencat, participimet, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj.

Gjithashtu, në vitin 2021 Komuna e Hanit të Elezit ka përfituar të hyra nga gjrobat në trafik në vlerë 8,844€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	288,624	288,624	316,657	230,239	297,255
Të hyrat tatimore	147,203	147,203	139,134	97,071	117,793
Të hyrat jo tatimore	141,421	141,421	177,523	133,168	179,462

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 për Komunën e Hanit të Elezit ka rezultuar me dy (2) rekomandime. Komuna ka përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2020 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, një (1) rekomandim është zbatuar, dhe një (1) rekomandim i pazbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore si dhe të shtojë kontrollet duke siguruar personel të Tatimit në Pronë që të bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore .	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Illir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hani të Elezit , për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Mehmet Ballazhi

(Kryetar i Komunës Hani i Elezit)

Data: 13.06.2022

M. Ballazhi



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ 1. Urdhërblerja në vlerë 11,532€ për punimet në ndërtimin e rezervuarit të ujësjellësit në fshatin Gorancë, është përgatitur një muaj pas skadimit të kontratës publike. 2. Urdhërblerja në vlerë 9,994€ për furnizim me paisje sportive për sallat e sportit nëpër shkolla është përgatitur dy javë pas skadimit të kontratës publike. 3. Urdhërblerja në vlerë 8,666€ për furnizim me paisje për kabinete (biologji dhe kimi) për SHML Dardania, është përgatitur dy javë pas skadimit të kontratës publike. 4. Urdhërblerja në vlerë 2,867€ për furnizimin dhe montimin e roletave për çerdhe, është përgatitur tre javë pas skadimit të kontratës publike. 5. Urdhërblerja në vlerë 4,208€ për furnizim me paisje për kabinete (biologji dhe kimi) për SHML Dardania, është përgatitur dy javë pas skadimit të kontratës publike
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.